

# Gjykata e Posaçme kthen dosjen e Adriatik Lallës për plotësim të hetimeve

Përfaqësuesi ligjor i ish-Prokurorit të Përgjithshëm Adriatik Llalla ka kërkuar kryerjen e hetimeve të mëtejshme për transaksionet e pronave dhe thirrjen e një dëshmitari.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Ish-kryeprokurori Adriatik Llalla. Foto: LSA

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vendosi të enjten të rikthejnë për kryerje hetimesh të reja hetimore dosjen penale në ngarkim të ish-Prokurorit të Përgjithshëm, Adriatik Llalla. Ka qenë përfaqësuesi ligjor i Llallës, avokati Sokol Hazizaj ai i cili i kërkoi gjyqtarës së seancës paraprake Irena Gjoka, që të rikthejë dosjen për rihetim. “Avokati kërkoi kryerjen e disa hetimeve të tjera dhe gjykata vendosi plotësimin e hetimeve”, njoftoi koordinatori për të drejtën e informimit pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, Dinora Aleksi, e cila shtoi se seanca e radhës do të zhvillohet në nëntor.

BIRN mësoi nga një burim që nuk preferoi të identifikohet se avokati Hazizaj ka kërkuar që të kryhet verifikimi i të gjitha transaksioneve të pronave të Llallës që janë hetuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, SPAK, për të konkluduar nëse ka fshehje ose fiktivitet. Gjithashtu, është kërkuar edhe thirrja e një dëshmitari që ka kryer një dhurim parash cash me rastin e lindjes së fëmijës së Llallës.

Ish-prokurori Adriatik Llalla ishte i paarritshëm për koment deri në publikimin e këtij shkrimi.

Dy seancat e mëparshme kur pritej të shqyrtohej kërkesa e SPAK për gjykimin e Lallës u shtynë. E para për shkak të kërkesës së avokatit për t'u njohur me dosjen dhe seanca e dytë u shty për shkak të mungesës së gjyqtarës Irena Gjoka për arsye shëndetësore.

Sipas SPAK-ut, ish-kryeprokurori Llalla ka kryer tre herë veprën penale të mosdeklarimit dhe fshehjes së pasurisë. Akuza e ngritur sipas nenit 257/a, parashikon dënime nga gjobë deri në 3 vjet burg.

Adriatik Llalla u zgjodh Prokuror i Përgjithshëm në vitin 2012 dhe e mbajti këtë post deri në nëntor 2017, kur i mbaroi mandati 5-vjeçar dhe u zëvendësua nga Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme, Arta Marku.

Hetimi ndaj Lallës u regjistrua fillimisht nga Prokuroria e Durrësit më 15 mars 2018 nën akuzat e fshehjes së pasurisë, shpërdorimit të detyrës dhe pastrimit të parave. Ai u hetua edhe për veprën penale të “mosdeklarimit të shumave monetare në kufi”.

Më pas, dosja u dërgua në ish-Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe në korrik 2018, gjykata respektive vendosi sekuestron e pronave të ish-Prokurorit të Përgjithshëm. Në një njoftim për shtyp të atëhershëm, Prokuroria e Krimeve të Rënda bëri të ditur se Lallës iu vendosën nën sekuestro një apartament 67 metra katrorë në Durrës dhe katër parcela toke me sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 22 mijë metrash katrorë në periferi të Tiranës.

Megjithatë, akuzat u rrudhën dhe SPAK njoftoi të më 9 mars përfundimin e hetimeve vetëm për veprën penale “refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të kryer tri herë.

Një investigim i mëparshëm i BIRN tregoi se si Llalla transformoi një investim fillestar prej 16.3 milionë lekësh në prona me vlerë mbi 1 milionë euro përmes transaksioneve me një person të dënuar për vrasje, një biznesmen-fitues tenderi në Prokurori dhe një instruktor hipizmi i përdorur si sekser tokash.



RRETH AUTORIT

## [Edmond Hoxhaj](#)

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.